



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:117625

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644443

KA.nr.215/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit K.K. B.I., me emër tregtar N.T.SH. “Bedi Com” me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues 810094201, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S. avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. “Migjeni” p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.P., për shkak të anulimit të Vendimit PSH.nr.1024/22; 1025/22; 1026/22 të datës 08.05.2023, pas shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur me datë 22.04.2024 në prezencë të përfaqësuesit të paditësit dhe të paditurit, me datë 30.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K.K. B.I., me emër tregtar N.T.SH. “Bedi Com”, dhe ANULOHET Vendimi PSH.nr.1024/22; 1025/22; 1026/22 i datës 08.05.2023 i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit.
- II. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e vendimit të kundërligjshëm të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit në shumë prej 698,718.00€.
- III. Ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- IV. Shtyrja e ekzekutimit të Vendimit PSH.nr.1024/22; 1025/22; 1026/22 të datës 08.05.2023 i nxjerrë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.215/23 i datës 02.06.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

## A r s y e t i m

Paditësi K.K. B.I., me emër tregtar N.T.SH. “Bedi Com” përmes përfaqësuesit të autorizuar ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me kërkesën për anulimin e Vendimit PSH.nr.1024/22; 1025/22; 1026/22 të datës 08.05.2023 si të kundërligjshëm. Paditësi përmes padisë ka theksuar se vendimi i kontestuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave ligjore pasi që në mënyrë të kundërligjshme OSHP ka aprovuar kërkesën e AK, të datës 28.10.2022, me të cilën ka diskualifikuar nga aktiviteti i prokurimit “Furnizimi me lëndë djegëse (dru ahue ose bunge)” me Nr. 621-22-8644-111, duke ia ndaluar pjesëmarrjen në aktivitetin e prokurimit publik për periudhën kohore në kohëzgjatje prej 6 muajsh duke filluar nga data 08.05.2023 deri më datën 08.11.2023 si dhe ka urdhëruar Autoriteti Kontraktues (AK) Komunën e Dragashit që t’ia konfiskojë sigurinë e tenderit në shumën prej pesë (5) mijë euro. Tutje në padi theksohet se paditësi asnjëherë nuk ka paraqitur të dhëna të rreme apo dokument të falsifikuar, ka theksuar se paditësi asnjëherë nuk ka pranuar kërkesë për sqarim nga AK edhe sikur të pranonte, paditësi ka mundur të eliminohet, por në asnjë mënyrë nuk mund të jetë bazë për diskualifikim mbi bazën e nenin 99 par. 2 i Ligjit për Prokurimin Publik dhe futjen në listë të zezë të paditësit, Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se vendimi i kontestuar është i kundërligjshëm pasi që i njëjti është nxjerr në kundërshtim me nenin 99 par. 2. të LPP-së. Po ashtu, ka konsideruar të kundërligjshëm edhe aplikimin e masës së konfiskimit të tenderit si të kundërligjshme sepse sipas nenit 57 të LPP është e përcaktuar saktë se në çfarë faze dhe në çfarë mënyre mund të vendoset që të konfiskohet siguria e tenderit. Paditësi thekson se vendimi i të paditurit është i kundërligjshëm sepse paditësi nuk ka qenë i përzgjedhur asnjëherë si fitues i mundshëm i tenderit, këtë e vërteton dhe fakti që vendimi i adresohet tërë operatorëve ekonomik njëkohësisht. Gjatë seancës së datës 23.02.2024 ka deklaruar se si pasojë e vendimit të të paditurit, paditësit i është pamundësuar që të marr pjesë në tenderët të cilat janë organizuar e që i ka pasur interes paditësi të marr pjesë, gjykatës në kopje i ka ofruar të dhënat e siguruar nga KRPP, pikërisht raportin që dëshmohet lista e tenderëve të cilët janë zhvilluar gjatë kësaj faze ku paditësi nuk ka pasur të drejtë të marr pjesë ku janë gjithsej 27 tender me vlerë të parashikuar 4,658,120.02€ e që sipas vlerësimit të paditësit në rast se do të fitoheshin këta tender fitimi i të njëjtit vlerësohet 15% të vlerës së parashikuar e që i bie vlera prej 698,714.00€, andaj i ka propozuar gjykatës që për shkak të dëmit të shkaktuar paditësit përmes vendimit të kundërligjshëm të ja kompensoj demin- fitimin humbur si pasojë e ndalimit të drejtës për pjesëmarrje dhe fitim të këtyre tenderëve gjatë periudhës 08.05.2023 deri me datë 08.11.2023 në shumën prej 698,718.00€. Gjykatës i ka

propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, të anuloj vendimin e kontestuar me padi si dhe të kompensohen shpenzimet e procedurës.

I padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigjen në padi, përmes të cilës e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar për faktin se tërheqja e OE, këtu paditësit konsiderohet si qasje jo serioze, e cila krijon dëme në ushtrimin e rregullt të detyrave të AK. Sipas të paditurit plotësimi i dokumenteve të kërkuara nga AK, është i domosdoshëm së paku në kuptim të nenit 64, 65 dhe 69. Ka shtuar se janë përmbushur të gjitha kushtet që OE të futet në listën e zezë. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vendimi është nxjerrë në përputhje me nenin 65, 69 dhe 99 të LPP si dhe në legjislacionin dytësor ku parashihet që një OE pjesëmarrës në procedurë të prokurimit nëse kalon fazën e kualifikimit dhe konsiderohet i përgjegjshëm të njëjtin i kërkojnë dokumente të përshtatshmërisë në mënyrë që të certifikohet se ai plotëson ato dhe në këtë mënyrë të shpallet i suksesshëm duke qenë se AK ofertuar me çmim më të lirë, kjo ka ndodhur me rastin konkret mirëpo paditësi edhe pse ka ofertuar vet në këtë procedurë të prokurimit me vonë është tërhequr duke mos i sjellë dokumentet e kërkuara nga AK dhe në këtë mënyrë këtë të fundit e ka kërkuar ta shpërblej me kontratë një OE me çmim më të lartë gjë që në mënyrë të tërthoret i ka shkaktuar dëm buxhetit publik të Komunë së Dragashit, andaj ka konsideruar se padia e paditësit është e pa bazuar dhe i ka propozuar gjykatës që pas vlerësimit dhe administrimit të provave të njëjtin ta refuzoj duke lënë në fuqi vendimin e OSHP.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Raportin e vlerësimit të tenderëve të datës 16.09.2022; Deklaratat nën betim të datës 16.09.2022; Njoftim mbi vendimin e AK të datës 22.09.2022; Letër standarde për tenderuesin e eliminuar për OE N.P.T “Acvilla”, N.T.SH “Bedi Com” dhe N.T.SH “Nazi Travel”; Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm për OE D.P.T. “Orana”; Deklaratë nën betim për “Bedi Com”; Certifikata e regjistrimit të biznesit dhe informatat për “Bedi Com”; Formulari për dorëzimin e tenderëve; Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 10.10.2022; Letër standarde e kërkesës për sqarim tenderi i datës 16.09.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Paditësi përmes Vendimit PSH.nr. 1024/22, 1025/22 dhe 1026/22 të datës 08.05.2023, kishte aprovuar si të bazuar kërkesën e datës 28.10.2022 të parashtruar nga AK, Komuna e Dragashit, e paraqitur për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga OE, sipas nenit 99 par.2 të LPP-së, me ç ‘rast ka diskualifikuar nga aktiviteti prokurimit “Furnizimi me lëndë djegëse (dru ahue ose bungu)” me Nr. 621-22-8644-111, duke ia ndaluar pjesëmarrjen në aktivitetin e prokurimit publik për periudhën kohore në kohëzgjatje prej 6 muajsh duke filluar nga data 08.05.2023 deri më datën 08.11.2023 si dhe ka urdhëruar Autoriteti Kontraktues (AK) Komunën e Dragashit që t’ia konfiskojë sigurinë e tenderit në shumën prej pesë (5) mijë euro.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, i cili përcakton se: *“3. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative”* si dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*.

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit për anulimin e vendimit kontestues pasi që i padituri nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, dhe vendimi i kontestuar nuk është nxjerr konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe provat për vërtetimin e gjendjes së saktë faktike nuk janë shqyrtuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar se:

Nga Letër standarde e kërkesës për sqarim tenderi i datës 16.09.2022, gjykata konstaton se i padituri kishte kërkuar nga paditësi sqarime lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale.

Nga Kërkesa për KRPP e datës 05.03.2024 dhe përgjigja e datës 05.03.2024, gjykata konstaton se paditësi N.T.SH. "Bedi Com" ka pranuar Letrën Standarde për Sqarim të Tenderit, të dërguar nga AK, Komuna e Dragashit me datë 17.09.2022.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 59 par. 2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP), ku përcaktohet se: *"2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues."*, si dhe pikës 38 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (Rregullorja), e cila ka përcaktuar se: *"38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. ... Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike. 38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet. 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate. 38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësisë të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura. 38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së, d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. 38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. 38.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet. 38.8 "Kërkesën për sqarim të tenderit" AK duhet*

*t'a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik. OE përgjigjen në "Kërkesën për sqarim të tenderit" duhet t'a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik".*

Në këtë drejtim gjykata vlerëson se i padituri përmes Letrës Standarde e Kërkesës për Sqarim të Tenderi të datës 16.09.2022, ka kërkuar nga paditësi sqarime lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale, ku në përputhje me dispozitat e lartcekura, në rast të mos përgjigjes nga OE, i padituri është dashur të veprojë në përputhje me pikën 38.7 e cila përcakton se: *"Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet."*

Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar edhe në përputhje me nenin 99 par 22, i cili përcakton se: *"2. Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare"*, ku gjeti se i padituri kishte vepruar gabimisht kur kishte diskualifikuar paditësin nga pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit publik për 1 vit, pasi që paditësi nuk ka bërë fare dorëzimin e dokumentacionit për plotësimin e tenderit, dhe kjo nuk mund të konsiderohet paraqitje e të dhënave të rreme, mirëpo përbënë bazë për eliminim nga procedura e prokurimit, respektivisht mos përgjigja ndaj kërkesës për sqarim siç përcakton neni 38 pika 7 e Rregullores, tenderi i OE do të refuzohet.

Sa i përket dispozitave të nenit 65 të LPP, në të cilat thirret i padituri në vendimin e kontestuar, gjykata sqaron se dispozita e nenit 65 par 1.1 dhe 1.2 i referohet përshtatmërisë së kandidatit dhe paraqitjes së deklaratës nën betim lidhur me përshtatshmërinë e tenderuesit për të marr pjesë në aktivitetin e prokurimit, mirëpo nga provat e administruara rezulton se i padituri përmes Letrës Standarde e Kërkesës për Sqarim të Tenderi të datës 16.09.2022, ka kërkuar nga paditësi sqarime lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale të përcaktuara me nenin 69 të LPP-së.

Andaj sipas vlerësimit të gjykatës, i padituri gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 65 par 1, nën par 1.1 dhe 1.2. si dhe neni 66 i LPP-së, pasi që të njëjtat nuk janë të zbatueshme në rastin konkret, përderisa bëhet fjalë për kapacitetin profesional dhe jo për deklaratën nën betim lidhur me konfliktin interesit.

Gjykata vendosi si në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi, në kuptim të nenit 43 të LKA-së i cili përcakton se: *"1. Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të*

vërtetuara në procedurën administrative. ... 3. Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin”, pasi që nga provat e administruara, gjeti se paditësi është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit, mirëpo mos përgjigja ndaj kërkesës për sqarim ka për pasojë eliminimin nga aktiviteti i prokurimit, dhe jo diskualifikim mbi bazën e nenit 99 par.2 të LPP-së.

Gjykata konsideroi të tërhequr zgjerimin e kërkesëpadisë të bërë nga përfaqësuesi i paditësit gjatë seancës së datës 23.02.2024, pasi që paditësi përkundër obligimit që në afat prej 15 ditëve nga dita e seancës të paguaj diferencën e taksës gjyqësore në shumë prej 950.00€, mirëpo i njëjti nuk ka bërë pagesën e diferencës së taksës, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitivin II të këtij Aktgjykimi.

Nisur nga fakti se paditësi përkundër paralajmërimit për pagesën e diferencës së taksës, nuk e ka vepruar, gjykata duke u bazuar në nenin 253 par. 5 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: “Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr. ”, ka vendosur që të konsideroj të tërhequr zgjerimin objektiv të kërkesëpadisë, pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë konditat për lirim të paditësit nga detyrimi i pagesës së diferencës së taksës gjyqësore.

Gjykata përfundimisht vlerësoi se i padituri me vendimin kontestues në procedurë administrative, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe dispozitat tjera ligjore, andaj duke u mbështetur në nenin 46 par. 4 të LKA-i cili përcakton se: “4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimin e zëvendëson aktin e anuluar.”, vendosi që të anuloi Vendimi PSH.nr.1024/22; 1025/22; 1026/22 i datës 08.05.2023, për shkaqet e elaboruara më lartë.

Duke qenë se gjykata në këtë çështje aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, gjykata vendosi që të lë në fuqi shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit PSH.nr.1024/22; 1025/22; 1026/22 të datës 08.05.2023 i nxjerrë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.215/23 i datës 02.06.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditurit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje të konfliktit administrativ.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, i cili përcakton që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 par.3 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.215/23, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimi, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.